



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr.31 , Datë 28.02.2019

MBI

PRANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “A.E. DISTRIBUTION” SH.P.K PËR HEQJEN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, gërma “dh”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 5 gërma “dh”; nenit 7, paragrafi 2, dhe nenit 9 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE, nr. 58, datë 18.04.2017, si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 28.02.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë “A.E. DISTRIBUTION” sh.p.k për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i Komisionerëve të ERE me Vendimin nr.82, datë 09.06.2016, ka licencuar shoqërinë “A.E DISTRIBUTION” sh.p.k në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “A.E DISTRIBUTION” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 157 Prot, datë 14.02.2019, ka kërkuar me vullnetin e saj të plotë, heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.
- Kërkesa e shoqërisë “A.E DISTRIBUTION” sh.p.k për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, vjen në zbatim të nenit 42, pika 1, gërma “dh”, “Heqja e një licence”, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 5, gërma “dh” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 58, datë 18.04.2017.

- Subjekti ka përmbushur të gjitha detyrimet që lidhen me pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “A.E DISTRIBUTION” sh.p.k për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit me energji elektrike me nr. 344 Seria T16, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 82, datë 09.06.2016.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi licenca e sipërcituar humbet fuqinë e saj juridike.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë kërkuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI